

09-01-2020

KOMUNA E SUHAREKËS OPSTINA SUVA REKA THE MUNICIPALITY OF SUHAREKA			
PRIMLJENO - RECEIVED			
Nësi org. Org. Jedinica Org. Unit	Nr. tit. Broj Number	Shifra Prilog Appendix	Vlera Vrednost Value
01	016	2054	2

REPUBLIKA E KOSOVËS

REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E SUHAREKËS - MUNICIPALITY OF
SUHAREKA

Nr.	Komisioni Komunal për zhvillimin e procedurave dhe shqyrtimin e ofertave për dhënie në shfrytëzim afatshkurtë dhe afatgjatë të pronës komunale	09.01.2020
-----	--	------------

Duke u bazuar në nenin 19 LIGJI NR. 06/L-092 për dhënie në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme të komunës, komisioni në përberje prej Emrush Bytyçi kryesues, Marigona Gashi, Antigona Kolgeci, Xhemajl Kabashaj dhe Driton Maliqaj anëtar, në çështjen juridike vlerësimin e Ankandit Publik Nr.03/2019 për dhënie në shfrytëzim afatshkurtë të parces kadastrale P-72116046-02785-79 në ZK Suharekë, në mbledhjen e mbajtur me datën 09.01.2020 në seancën jo publike gjatë shqyrtimit komisioni njëzëri vendosi që të nxjerr këtë vendim dhe atë duke u bazuar në nenin 44, lidhur me nenin 48, të Ligjit Nr-05/L-031, për Procedurën e përgjithshme Administrative:

VENDIM

- I. ANULOHET – Ankandit Publik Nr.03/2019 i shpallur me datë 12.12.2019 për parcelën kadastrale:- P-72116046-02785-79 sipas çertifikatës së pronës Nr.4774/2019, të datës 08.10.2019 me sipërfaqe të përgjithshme prej 39779m², Zona Kadastrale Suharekë, vendi i quajtur “Shiroko”, pasuri shoqërore në emër të Kuvendit Komunal-Suharekë, nga sipërfaqja e përgjithshme prej ; 200 m² ndahen për ndërtimin e lokalit afarist të karakterit të përkohshëm.
- II. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

ARSYETIM

Komuna e Suharekës përkatësisht komisioni për zhvillimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim afatëgjatë dhe afatshkurtë të pronës së paluajtshme komunale ka bërë shpalljen e Ankandit Publik Nr.03/2019 të datës: 12.12.2019 me Nr. protokollit 11-016-81173 për dhënie në shfrytëzim afatshkurtë të pronës së paluajtshme të komunës për parcelën P-72116046-02785-79 sipas çertifikatës së pronës Nr.4774/2019, të datës 08.10.2019 me sipërfaqe të përgjithshme prej 39779m², Zona Kadastrale Suharekë, vendi i quajtur “Shiroko”, pasuri shoqërore në emër të Kuvendit Komunal - Suharekë, nga sipërfaqja e përgjithshme prej ; 200 m² ndahen për ndërtimin e lokalit afarist të karakterit të përkohshëm.



Në këtë ankand publik kanë konkuruar gjithësej dy persona fizik :

Valbona Kuçi- me vendbanim në Suharekë, aplikuese në Ankandit Publik 03/2019 me numër të protokolit 01-016-826 të ofertës të datës 06.01.2020.

Shkelqim Ramaj- me vendbanim në Reqan- Komuna e Suharekës, aplikues në Ankandin Publik 03/2019 me numër të protokolit 01-016-832 të ofertës të datës 06.01.2020.

Komisioni i lartëcekur me datë 06.01.2020 ka bërë hapjen e ofertave ku prezent ka qenë edhe ofertuesja Valbona Kuçi, ndërsa me datë 09.01.2020 komisioni pas shqyrtimit të dokumentacionit të ofruar nga ofertuesit e lartëcekur ka marrë vendimin për Anulimin e Konkurimit të Hapur 03/2019, për shkak se të dy ofertuesit e lartëcekur në prezentimin e **Planit Ideor**, nuk është qartësuar karakteri i objektit të përkoshëm (montazhë) sipas vendimit të Asamblesë si dhe njoftimit për Ankand Publik, andaj në bazë të dispozitave ligjore njëzëri vendosi që këtë procedurë të Ankandit Publik ta anulojë dhe për të njëjtën të fillojë procesi i ri-Ankandit Publik .

Këshillë juridike: kundër këtij vendimi pala e pakënaqur ka të drejtë të bëjë ankesë në afat prej 7 (shtatë ditësh) nga dita e pranimit të këtij vendimi në komisionin e ankesave i themeluar nga Kuvendi i Komunës në Suharekë.

Kryesuesi i komisionit:



Emrush BYTYÇI

